

VENDIM
Nr.650, datë 29.12.1999

PËR DIA NDRYSHIME NË VENDIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.103, DATË 27.2.1999, “PËR KRIJIMIN E KOMITETIT KOMBËTAR PËR DECENTRALIZIMIN E PUSHTETIT VENDOR DHE MIRATIMIN E PROJEKTPLANIT STRATEGJIK TË DECENTRALIZIMIT”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe me propozimin e zëvendëskryeministres dhe ministre e Punës dhe Çështjeve Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1.Pika 2 e vendimit të Këshillit të Ministrave nr.103, datë 27.2.1999, ndryshohet si vijon:
“Komiteti Kombëtar për decentralizimin e pushtetit vendor drejtohet nga zëvendëskryeministrja dhe ka në përbërje këta anëtarë:

- 1.Ministrin e Financave;
- 2.Ministrin e Drejtësisë;
- 3.Ministrin e Pushtetit Lokal;
- 4.Drejtorin e Departamentit të Administratës Publike;
- 5.Drejtorinë e Departamentit të Përafrimit të Legjislacionit, pranë Këshillit të Ministrave;
- 6.Kryetarët e shoqatave të zgjedhurve vendorë”

2.Pika 4 ndryshohet si vijon:

“Në mbështetje të veprimtarisë së Komitetit Kombëtar për decentralizimin e pushtetit vendor, funksionon grupi teknik i ekspertëve, i cili përgatit materialet dhe projektet që shqyrtohen e miratohen nga ky komitet. Grupi i ekspertëve raporton para këtij komiteti të paktën një herë në muaj”.

3.Pika 5 ndryshohet si vijon:

“Përbërja dhe drejtuesi i grupit të ekspertëve caktohet nga Komiteti Kombëtar për decentralizimin e pushtetit vendor. Në varësi të fushave dhe të çështjeve që trajtohen në grupin e ekspertëve të caktohen drejtues, në nivel drejtor drejtorie, dhe ekspertë nga ministritë, nga Departamenti i Administratës Publike, nga shoqata e të zgjedhurve vendore nga institucionet shkencore, organizatat joqeveritare, si dhe ekspertë të huaj”.

4.Pika 7 ndryshohet si vijon:

“Ngarkohen zëvendëskryeministrja dhe Ministria e Pushtetit Lokal për zbatimin e këtij vendimi”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta